



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e enjte, në datën 26 dhjetor 2019, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Top Albania” sh.a., për subjektin audio kombëtar privat “Top Albania Radio”. (**Vendimi nr. 196, datë 26.12.2019**)
2. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Nacional A.H” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio Nacional”. (**Vendimi nr. 197, datë 26.12.2019**)
3. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Arben Lame, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Tivo Cable” dhe zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit në “*Bashkinë Konispol*”. (**Vendimi nr. 198, datë 26.12.2019**)
4. Dhënien e autorizimit, shoqërisë “Albanian Fiber Systems” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor AFS” me zonë ofrimi shërbimi në njësitë administrative “*Qendër Bulgarec, Drenovë, Pojan, Udenisht dhe Buçimas*” (**Vendimi nr. 199, datë 26.12.2019**)
5. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “TIBO” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (OTT) “TIBO”. (**Vendimi nr. 200, datë 26.12.2019**)
6. Pranimin e ankimit administrativ të subjektit person fizik Besim Sula dhe shfuqizimin e vendimit me gjobë, nr. 20, datë 02.12.2019, në masën 1,000,000 lekë të vendosur ndaj subjektit “Tv me kabëll Sulova”. (**Vendimi nr. 201, datë 26.12.2019**)

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**